

## “Muslimanët e adhurojnë një Zot të ri të quajtur All-llah”

KEQKUPTIMI #3

Disa jomuslimanë gabimisht mendojnë se muslimanët adhurojnë një Zot të ndryshëm nga ai i hebrenjve dhe i krishterëve. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se muslimanët ndonjëherë i referohen Zotit si “All-llah”. Në fakt, muslimanët adhurojnë Zotin e Nuhit, Ibrahimit, Musait, Isait. Fjala “All-llah” është thjesht fjala arabe për fjalën Zot i Plotfuqishëm - fjalë arabe me kuptimi të pasur, që paraqet një dhe të vetmin Zot. All-llahu është fjala e njëjtë që krishterët dhe çifutët arabishtfolës e përdorin për t’iu referuar Zotit. Nëse ju bie në dorë një përkthim arabisht i Biblës, do të shihni fjalën “All-llah”, në vendet ku fjala “Perëndi” është përdorur në gjuhën shqipe.

Megjithatë, edhe pse muslimanët, çifutët dhe të krishterët besojnë në të njëjtin Zot (Krijuesin), konceptet e tyre lidhur me atë Zot ndryshojnë ndjeshëm. Për shembull, muslimanët e kundërshtojnë idenë e Zotit të ketë ndonjë partner apo të qenit pjesë e ‘trinitetit’, dhe i përshkruajnë përkryerjen e vetme Zotit të plotfuqishëm.

## “Islami lejon terrorizmin”

KEQKUPTIMI #4

Ky është ndoshta keqkuptimi më i madh për Islamin, sidomos duke pasur parasysh stereotipet e vazhdueshme nga ana e mediave. Media e përshkruan si një terrorist çdo musliman që lufton pa marrë parasysh nëse ata luftojnë me të drejtë apo jo, ose nëse ata e shtypin dikë apo janë të shtypur nga dikush. Pra, pyetja që vjen në mendje është: A e nxit Islami terrorizmin? **Sigurisht që jo!** Islami plotësisht ndalon dhe dënon këto akte të gabuara objektivi i të cilave janë civilët e pafajshëm.

Sigurisht, Islami nuk do të qëndrojë i heshtur ndaj shtypjes, padrejtësisë dhe poshtërimit. Çdo fe apo qytetërim që e bën këtë, kurrë nuk do të mbijetojë --- por kjo sigurisht se nuk i bën të lejueshme sulmet kundër meshkujve, femrave dhe fëmijëve të pafajshëm.

“Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën).”  
Kur’an 2:190

Edhe në kohë lufte, Islami cakton rregulla të rrepta. Për shembull, një muslimani nuk i lejohej të dëmtojë ose t’i mbysë ata që kanë marrëveshje paqeje me muslimanët, ata që nuk janë luftëtarë, gratë, të miturit, shërbëtorët, të verbërit, murgjit, të moshuarit, ata që janë fizikisht të paaftë të luftojnë dhe të sëmurët mentalë. Në fakt, muslimanët nuk janë të lejuar të dëmtojnë apo të djegin të mbjellat gjatë kohës së luftës! Këto parime fisnike të etikës ishin, dhe ende mbeten, diçka e paparë në ndonjë ushtri.

*Kur’ani tregon qartë seriozitetin e vrasjes së një personi të pafajshëm dhe thekson vlerën e jetës njerëzore. Në të njëjtën kohë i udhëzon muslimanët për t’i trajtuar njerëzit e besimeve të tjera me dashamirësi.*

“Ai që mbyl ndokend, i cili s’ka mbytur askend, ose atë që nuk ka bërë çrregullim në Tokë – është sikur t’i mbysish të gjithë njerëzit; e nëse ndokush bëhet shkaktar që të shpëtojë jetën e ndokujt – është sikur me i shpëtuar jetën e të gjithë njerëzve.”  
Kur’an 5:32

“All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë.”  
Kur’an 60:8

*Pra, si pas leximit të këtyre vargjeve të qarta të Kur’anit, a mund të fajësohet Islami për atë që veprojnë terroristët?*

## Përfundim

Shumë përpjekje janë bërë për të portretizuar Islamin si një fe të çuditshme dhe të huaj ndaj instinkteve të njerëzve dhe vlerave normale. Në marrjen e vendimeve mbi atë se çfarë është Islami, mos e harroni këtë:

- Kush mund të përfitojë nga përjetësimi i këtyre ideve të gabuara dhe të pavërteta?
- A keni hulumtuar vetë lidhur me Islamin, në krahasim me atë që keni dëgjuar nga të tjerët apo nga mediat?
- A do të pranoni miliona njerëz në të gjithë botën Islamin nëse kjo do të ishte një mënyrë e ashpër dhe çnjerëzore e jetës.

### Informacion

tel 045 633 370 web islamifejaevartetete.com @ broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

# Keqkuptimet për Islamin

## Çfarë dini në të vërtetë?

gjërat  
themelore

islamifejaevartetete.com



# Hyrje

*A keni menduar ndonjëherë pse një murgeshë mund të mbulohej prej kokës deri te këmbët dhe ajo respektohet për devotshmërinë e saj ndaj Zotit, por kur një grua muslimane mbulohej, ajo vështrohet si “e shtypur”? Ose pse kur një çifut është duke rritur mjekrën ai është vetëm duke praktikuar besimin e tij e kur një musliman e bën atë ai është një “ekstremist”?*

Njerëzit duket se kanë shumë ide të gabuara rreth muslimanëve dhe Islamit. Shumë besojnë se bota perëndimore është e përparuar, e shkolluar dhe liberale, ndërsa Islami është vetëm e kundërta: primitiv, injorant dhe shtypës. Arsyeja e këtij opinioni është se mediat ka kohë që portretizojnë muslimanët në kundërshtim me mënyrën e mësimave islame. Çelësi për të kuptuar Islamit dhe muslimanët është që të rezistosh stereotipet dhe të shqyrtojsh çdo situatë sipas mësimave islame, dhe **jo** sipas veprimeve të disa muslimanëve. Për këtë arsye, ne kemi ndjerë për detyrë që të trajtojmë keqkuptimet më të zakonshme.

Arsyeja që gratë muslimane zbatojnë mbulesën është thjesht për shkak se All-llahu (Zoti) e bëri atë një akt të detyrueshëm të adhurimit për to dhe All-llahu e di se çfarë është më e mirë për krijesën e Tij.

Mbulesa u jep grave lirinë e të qenit anëtarë aktivë të shoqërisë duke ruajtur modestinë e tyre. Mbulesa është e obligueshme të mbahet në publik, ndërsa kur femra është në shtëpi me familjen e saj të ngushtë nuk është e obligueshme ta mbajë atë!

*“O ti Pejgamber, thua ju grave tua, bijave tua e grave të besimtarëve le t’i vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen...”  
Kur’an 33:59*

Mbulesa nuk simbolizon shtypje apo heshtje. Përkundrazi, kjo është një mburojë ndaj vërrejtjeve degraduese, veprimeve të padëshiruara dhe diskriminimit të padrejtë. Nga të gjithë njerëzit që kanë pranuar Islamit, 75% janë femra! A do të hynit në një fe që ju shtyp? Kështu që herën tjetër që shihni një grua muslimane dijeni se **ajo mbulon pamjen e saj fizike, e jo mendjen apo intelektin e saj!**

- zgjedhjen e bashkëshortit e tyre;
- të mbajë mbiemrin e vet kur të martohet;
- të posedojë pronë të saj, të drejtojë biznes, të studiojë dhe të marrë pagë të barabartë për punë të barabartë;
- të trashëgojë pasuri dhe të ketë mundësi ta prishë martesën e saj në rast neglizhimi apo keqtrajtimit;
- të merr pjesë në të gjitha format e adhurimit në të cilat marrin pjesë meshkujt.

*Islami i ka garantuar këto të drejta, në mesin e shumë të tjerave, për femrat mbi 1400 vjet më parë - të drejta që ende u mungojnë femrave në Perëndim.*

Pa dyshim, ka femra muslimane që janë të shtypura dhe nuk i gëzojnë të drejtat e tyre. Megjithatë, ky nuk është faji i Islamit. Problemi është se në shumë vende në botë, kultura dhe tradita i kanë lënë nën hije mësimet e Islamit, ose përmes injorancës ose përmes praktikave të dëmshme kulturore.

Ndërsa Islami ruan të drejtat e femrave, gjithashtu e pranon faktin se meshkujt dhe femrat **nuk janë identikë.**

*All-llahu thotë: ‘...mashkulli nuk është si femra...’  
Kur’an: 3:36*

Për këtë shkak Islami ka paracaktuar role të ndryshme për meshkujt dhe femrat për të pasqyruar këtë fakt të padiskutuueshëm. Femrave u është dhënë nderi dhe përgjegjësia e madhe e kujdesit për familjen dhe shtëpinë ndërsa meshkujve u është dhënë përgjegjësia e sigurimit të përkrahjes financiare, siguria dhe mirëmbajtja e familjes dhe shtëpisë.

Në përfundim: pozita e lartë e grave në Islam mund të përmbledhet me këtë fjalë të Pejgamberit Muhamed (paqja qoftë mbi të):

“E gjithë kjo botë është një pasuri dhe pasuria më e mirë e kësaj bote është gruaja e devotshme.”

## ? “Mbulesa paraqet shtypje”

KEQKUPTIMI #1

Pra çfarë është mbulesa në të vërtetë? Për të zbatuar mbulesën është nevojshme që gratë muslimane të mbulojnë trupin e tyre me rroba modeste që nuk shfaqin figurën e tyre para meshkujve të huaj. Megjithatë, mbulesa nuk ka lidhje vetëm me paraqitjen e jashtme, por edhe me fjalët fisnike, modestinë dhe sjelljet dinjitoze. Është e kuptueshme se këto sjellje janë të nevojshme edhe për meshkujt.

Nuk ka asgjë në mbulesë që e kufizon lirinë e një gruaje muslimane për të shprehur pikëparjet dhe opinionet e saj, të së drejtës së pronës, të jetë e arsimuar dhe të ketë karrierë, ose për zgjedhjen një bashkëshorti. Hixhabi është një vepër e nderit dhe dinjitetit, një fuqizim, dhe një garanci që një grua do të gjykohet në bazë të bukurisë së brendshme (shpirtërore) dhe jo nga pamja e jashtme e saj (sipërfaqësore). Mbulesa e pavarëson dhe e lartëson statusin e një gruaje, dhe kërkon që ajo të gjykohet sipas intelektit dhe jo seksualitetit të saj.

## ? “Islami i shtyp femrat”

KEQKUPTIMI #2

Një nga idetë e gabuara dhe më shqetësuese është portreti negativ i femrave në Islam - domethënë se Islami i shtyp femrat. Sipas mësimave të Islamit, e vetmja gjë që dallon njerëzit në sytë e Zotit është niveli i tyre i devotshmërisë.

Ky ajet dëshmon vërtetë se nderi dhe statusi nuk arrihen për shkak se një person është i pasur apo i varfër, i zi ose i bardhë, mashkull apo femër, por arrihet nëpërmjet devotshmërisë dhe përlësisë ndaj Zotit. Prandaj, nuk është befasi që mësojmë se për çdo mashkull që konvertohet në Islam konvertohen katër femra. Disa arsye për këtë shkallë të madhe të konvertimit të femrave janë këto të drejta që ka femra në Islam:

- kontrollin total të pasurisë së tyre;

*“S’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat).”  
Kur’an 49:13*

Ky ajet dëshmon vërtetë se nderi dhe statusi nuk arrihen për shkak se një person është i pasur apo i varfër, i zi ose i bardhë, mashkull apo femër, por arrihet nëpërmjet devotshmërisë dhe përlësisë ndaj Zotit. Prandaj, nuk është befasi që mësojmë se për çdo mashkull që konvertohet në Islam konvertohen katër femra. Disa arsye për këtë shkallë të madhe të konvertimit të femrave janë këto të drejta që ka femra në Islam: